



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 925/2 Prot.

Tiranë, më 25.03 2025

V E N D I M

Nr. 41 dt. 25.03 2025

“PËR

MIRATIMIN E RELACIONIT TË GRUPIT TË PUNËS, NGRITUR ME VENDIMIN NR.36, DATË 05.03.2025 TË SENATIT AKADEMIK TË UST “PËR VERIFIKIMIN E GJETJEVE TË RAPORTIT TË MAS PËR PROCESIN E PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024 NË PROGRAMIN E CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË “SHKENCA SPORTIVE” NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË LËVIZJES”

Mbështetur në nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në neni 20 të Statutit të UST-së, në nenin 7 të Rregullores së Universitetit të Sporteve të Tiranës, në shkresën nr.795/4.Prot, datë 12.03.2025 “Relacion i Grupit të Punës”, ngritur me Vendimin nr.36, datë 05.03.2025 të Senatit Akademik të UST “Për verifikimin e gjetjeve të raportit të MAS për procesin e pranimit për vitin akademik 2023-2024 në programin e ciklit të tretë “Doktoratë” në “Shkenca Sportive” në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, shresën nr.904.Prot, datë 20.03.2025 mbi përfundimet dhe rekomandimet e Relacionit të grupit të Punës, Raportin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 5316/4 Prot. datë 27.12.2024 dhe shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr.539/1 Prot., datë 13.02.2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 25.03.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Relacionit të Grupit të Punës/Përfundimeve dhe Rekomandimeve mbi verifikimin e gjetjeve të Raportit të MAS për procesin e pranimit për vitin akademik 2023-2024 në programin e ciklit të tretë “Doktoratë” në “Shkenca Sportive” në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes.
2. Vazhdimin e studimeve në programin e ciklit të tretë të Doktoratës në “Shkenca Sportive” në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes për 5 (pesë) kandidatë të cilët kanë dokumentacion të plotë dhe janë në përputhje me kërkesat dhe kriteret e pranimit për këtë program. Përcjelljen e kërkesës pranë MAS dhe QSHA për vijimin e procedurës për matrikullimin e tyre. Bashkëlidhur këtij vendimi, *Tabela 1*, me listën e kandidatëve sipas pikës 2 të këtij Vendimi.

3. Ndjekjen e procedurës për çrregjistrimin nga programi i ciklit të tretë të Doktoratës në “Shkenca Sportive” në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes për 3 (tre) kandidatët e tjerë të cilët u gjetën jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret e pranimit për këtë program. Bashkëlidhur këtij vendimi *Tabela 2* me listën e kandidatëve sipas pikës 3 të këtij Vendimi.
4. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko Shkencore.
5. Një kopje e këtij Vendimi i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA



Tabela 1 (lista e kandidatëve sipas pikës 2 të këtij vendimi)

Kandidatët që vijojnë studimet në programin “Shkenca Sportive”		
Nr.	Emër	Mbiemër
5	ERGYS	REXHAJ

Tabela 2 (lista e kandidatëve sipas pikës 3 të këtij vendimi)

Kandidatët për çrregjistrim nga programi “Shkenca Sportive”		
Nr.	Emër	Mbiemër
1	MARINA	SHALLINI

